



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Nr. 08

Prishtinë, më 20. 04. 2010, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

Nga dëgjimi publik i Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Ismet Beqiri – kryetar, Nerxhivane Dauti, Hajredin Hyseni, Luljeta Shehu, Ibrahim Makolli, Danush Ademi, Ibrahim Selmanaj dhe Drita Maliqi.

Mungoi: Shpresa Murati.

Të ftuar: Fatmir Fehmiu - SPPIPK, Pajazit Nushi – KMDL NJ, Shahin Bajgora – SPPIPK, Ramadan Ademi - SKT.

Pjesëmarrës të tjerë: Mimoza Ahmetaj dhe Bujar Dugolli – deputetë, Driton Selmanaj – KDI, Elita Vokshi dhe Sanije Berisha - OSBE, Valbona Mazreku - Selimi, RTV - 21 dhe Xhemajl Ahmeti – OHCHR.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj - koordinators dhe Visar Krasniqi.

Dëgjimin publik me temën: Shqyrtimi i petitionit të Sindikatës së Pavarur të Pensionisteve dhe Invalidëve të Punës së Kosovës, që e udhëhoqi z. Ismet Beqiri – kryetar i Komisionit

Kryetari - I përshëndeti të pranishmit: z. Fatmir Fehmiun, kryetar të SPPIPK- së, z. Pajazit Nushin e Shahin Bajgorën, si dhe ata që e monitorojnë punën e Komisionit. Ai i njoftoi të pranishmit se Komisioni ka vendosur që në mbledhjen 9. 4. 2010, të mbahet dëgjim publik për shqyrtimin e kërkesave të petitionit të Sindikatës së Pavarur të Pensionisteve dhe Invalidëve të Punës së Kosovës (SPPIPK-së).

Fatmir Fehmiu - Në fjalën e tij e paraqiti një kronologji të veprimit të kësaj sindikate lidhur me mbrojtjen dhe me kërkesat e tyre të garantuar me Kushtetutë të Republikës së Kosovës, si dhe me aktet normative të miratuara nga OKB – ja. Gjithashtu tha se arsyetimin e petitionit e ka quajtur si mjet paralajmërues legjitim për shkak të paaftësisë, dobësisë, pamjaftueshmërisë dhe mungesës së vullnetit.

Diskutimi i tij më gjerësisht do të jepet në transkript.

Pajazit Nushi - Në emër të Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, theksoi se para gjashtë vjetëve kam folur për temën: “E drejta për jetë “ dhe “E Drejta për pronësi “. Lidhur me këto tema kam theksuar se këto të drejta janë të lidhura me dinjitetin e pacenueshëm të njeriut, që njëkohësisht është baza e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Ramadan Ademi - Duke folur për gjendjen e punëtorëve të kombinatit “ Trepça “ tha se anëtarëve të kësaj sindikate u mungojnë edhe gjërat elementare, dhe kërkoj që sa më parë të ndërmerret diçka për përmirësimin e gjendjes së tyre. Pastaj diskutoi z. **Shahin Bajgora**,

Drita Maliqi - Theksoi se rekomandimet e nxjerra nga legjislatura e dytë e Kuvendit, të miratuara më 7 korrikut 2005, nuk janë realizuar nga Qeveria e kaluar dhe e tashmja. Ajo i propozoi Komisionit të formohet një nënkomision, që t’i shqyrtojë me seriozitetin më të madh çështjet e ngritura dhe rekomandimet e vitit 2005.

Luljeta Shehu - Duke u ndërlidhur me kërkesat e pensionistëve tha: “ Është e drejtë njerëzore që të drejtat pensionistëve të Kosovës të rregullohen me ligje bazike”. Ajo ceku se Ligji për sigurimet shëndetësore në tri legjislaturat është duke u sjellë në relacion Qeveri dhe ministri. Si Komision duhet të kërkohet nga Qeveria që t’i procedojë ligjet bazike në kuvend, siç janë: P /ligjin për punën, P/ligjin për sigurimet shëndetësore dhe P/ligjin pensional dhe invalidor.

Hajredin Hyseni - I përkrahu kërkesat e pensionistëve duke shtuar se si shtet i ri kemi trashëguar një mori problemesh dhe sigurisht që edhe kërkesa e pensionistëve është e drejtë. Duke folur rreth rekomandimeve të vitit 2005, i pyeti përfaqësuesit e sindikatës së pensionistëve se a duhet të ndryshohen apo shtuar rekomandime të tjera? Gjithashtu, ishte i mendimit në këtë dëgjim të marrë pjesë edhe Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në mënyrë që t’i harmonizojnë rekomandimet për Kuvend.

Pyetjeve rreth rekomandimeve të vitit 2005, ju përgjigj Fatmir Fehmiu, kryetar i SPPIPK - së.

Ibrahim Selmanaj - Theksoi se kemi përvoja në këtë fushë, por nëpërmes këtij Komisioni është krijuar mundësia më e mirë e komunikimit. Ai tha se Komisioni, së bashku me Komisionin për financa, Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, duhet të kenë një strategji para vetes, duke bërë krahasime me vendet e tjera të Evropës Juglindore.

Ne fund shprehu gatishmërinë që të jetë në shërbim të ofrimit të përvojave në gjetjen e një zgjidhje të mundshme.

Bujar Dugolli - Duke u ndërlidhur me parafolësit tha se është çështje që duhet të ketë një zgjedhje urgjente për çështje humanitare, ekzistenciale dhe të dinjitetit. U pajtua me parafolësit se ka shkelje të Kushtetutës dhe të të drejtave të njeriut. Theksoi se jemi dëshmitar të ashtuquajturit “diskriminim pozitiv” në raport me drejtat e pakicës.

Nuk është insistuar të kërkohet për qytetarët e Kosovës në borxhet që i ka shtetit i Serbisë, duke përfshirë edhe çështjet e pensionistëve, fondit të privatizimit, etj. Duhet të jetë në interes për Kosovën,

sepse në diskutimet që do të pasojnë për çështje teknike me palën serbe, është e nevojshme të ngritën këto probleme.

Kryetari - Në fjalën përmbyllëse falënderoi përfaqësuesit e sindikatës për informimin që i bënë Komisionit dhe premtoi se brenda mundësive ekzistuese Komisioni do të angazhohet për realizimin e të drejtave të tyre.

Pasi një debati të gjerë dhe konstruktiv, Komisionit lidhur me këtë nxori:

P e r f u n d i m

Komisioni vendosi që në mbledhjen e radhës të nxirren rekomandimet, të cilat pas miratimit të tyre do të procedohen për Kuvend.

Përfundoi në orën 15: 20

Kryetari i Komisionit

Ismet Beqiri